



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KOMISIONERI PËR MBROJTJEN NGA DISKRIMINIMI

Nr.1688 Prot.

Tiranë, më 19. 12 . 2024

**V E N D I M**

**Nr. 311, Datë 19. 12 . 2024**

Bazuar në nenin 32/1/a dhe nenin 33 të ligjit 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi mori në shqyrtim ankesën nr. 222 Regj., datë 01.11.2024, paraqitur nga z. R.M , kundër Shkollës 9-Vjeçare “Naum Veqilharxhi”, Korçë dhe Ndërmarrjes së Shërbimeve Mbështetëse të Arsimit dhe Çerdhes, pranë Bashkisë Korçë, në të cilën pretendon diskriminimin të vajzës së tij të mitur J.M , për shkak të “*gjendjes ekonomike*”.

Në përfundim të shqyrtimit të ankesës, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

**K O N S T A T O I:**

**I. Parashtrimi i fakteve sipas subjektit ankues.**

Sipas shpjegimeve të dhëna në formularin e ankesës, z. R.M , në mes të tjerash informon se: *“Qnhem R.M dhe jam banor i Bashkisë Korçë. Jam prind i dy vajzave të cilat studiojnë në shkollat 9 vjeçare Naum Veqilharxhi dhe Demokracia. Jam familje në nevojë pasi trajtohem me ndihmë ekonomie në masën 6500 lekë. Jam 4 pjesëtarë në familje.*

*Vitin e kaluar nuk kam qenë përfitues i VKM 666, për marrjen e bursës për vajzat e mia edhe pse gëzoja këtë status, pasi drejtuesit e shkollës dhe punonjësit pranë Bashkisë Korçë më thanë që nuk përfiton sepse je me ndihmë ekonomike. Kam shkuar në bashki dhe kam takuar kryetarin z.S.F, kam ngritur problematikën edhe në KB, por nuk munda të isha fitues. Kam marrë vesh se shumë familje në Korçë që kanë gëzuar këtë status ishin drejtuar pranë Zyrës Rajonale të Komisionerit dhe kishin marrë zgjidhje.*

*Edhe këtë vit është e njëjta situatë. Përgatita të gjithë dokumentacionin e duhur, shkoj pranë shkollës për ta dorëzuar, por drejtoret e të dyja shkollave më thanë që nuk mund të jesh përfitues sepse nuk e kemi këtë kriter për t’ju ndihmuar ju. Kalvari im ishte përsëri i gjatë duke shkuar tek*

*drejtoria mbështetëse dhe tek Kryetari i Bashkisë, por përsëri e njëjta situatë. Për këtë arsye vendosa të drejtohem pranë jush për të marrë zgjidhje. Vajzat e mia janë nxënëse të shkëlqyera në mësim dhe frekuentojnë shkollën çdo ditë. Unë se bashku me bashkëshorten time mundohemi të punojmë për të plotësuar kërkesat e tyre që të mos ngelen prapa nga shokët dhe shoqet e klasës.”*

Përfundimisht ankuesi kërkon nga Komisioneri, hetimin e rastit për diskriminim për shkak të gjendjes ekonomike dhe rekomandimin për marrjen e bursës.

## **II. Ndjekja e procedurës për shqyrtimin e ankesës nga Komisioneri.**

Hapat proceduralë të ndjekur nga strukturat përkatëse të Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi, paraqiten si më poshtë vijojnë:

Pas analizimit paraprak të ankesës nr. 222, datë 01.11.2024, të bërë nga z. R.M u konstatua se nga pikëpamja formale, ajo i plotësonte kërkesat e parashikuara nga neni 33/3 të ligjit 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar. Në këto kushte Komisioneri, filloi procedurat përkatëse për shqyrtimin e saj.

1. Me shkresën nr. 1501/1, datë 05.11.2024, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, ka kërkuar informacion dhe dokumentacion shkresor nga ana e Shkollës 9-Vjeçare “Naum Veqilharxhi”, Korçë dhe Ndërmarrjes së Shërbimeve Mbështetëse të Arsimit dhe Çerdhes, pranë Bashkisë Korçë, lidhur me veprimet e kryera prej saj, përse i takon pretendimeve të subjektit ankues.

Nëpërmjet shkresës së sipërcituar, Komisioneri bëri me dije dhe kërkoi informacion në lidhje me problematikën e parashtruar në ankesë edhe nga Bashkisë Korçë.

Me qëllim parandalimin e cenimit të të drejtave dhe interesit të ligjshëm të palës ankuese, Komisioneri kërkoi marrjen e masave të menjëhershme për pranimin e aplikimit/dokumentacionit të palës ankuese, për përfitimin e bursës për vajzën e tij të mitur J.M .

2. Me shkresën me nr. 336 prot., datë 08.11.2024, Shkolla 9-Vjeçare “Naum Veqilharxhi”, Korçë, ka njohur Komisionerin me parashtrimet dhe qëndrimin e saj lidhur masat e ndërmarra në kuadër të pretendimeve të ankuesit.
3. Me shkresën me nr. 10532/1 prot., datë 11.11.2024, të Bashkisë Korçë, Komisioneri u informua se, kjo e fundit me qëllim zbatimin e rekomandimit të Komisionerit por edhe në zbatim të legjisllacionit në fuqi, ka kërkuar nga Shkolla 9-vjeçare “Naum Veqilharxhi”, që të marrë masa dhe të pranojë dokumentacionin e aplikantëve që pretendojnë se përfitojnë bursë.

4. Në vijim të shqyrtimit të kësaj çështjeje, subjekti ankues, nëpërmjet *email-it* të datës 16.12.2024, ka paraqitur para Komisionerit kërkesën për tërheqjen nga ankesa, pasi konsideron se ajo mori zgjidhje. Ankuesi ka konfirmuar se kërkesa për pranimin e dokumentacionit për përfitimin e bursës së fëmijës së tij, nga ana e Shkollës, ishte realizuar me ndërmjetësimin e Komisionerit dhe se e konsideron të përmbushur qëllimin për të cilin kishte paraqitur ankesën pranë Komisionerit.

Në këto kushte, Komisioneri vlerëson se qëllimi për të cilin ishte filluar hetimi administrativ është përmbushur në thelb, dhe në referencë të nenit 33, pika 9, të ligjit 10221/2010 “*Për Mbrojtjen nga Diskriminimi*”, të ndryshuar, ku parashikohet se: “*Kur e sheh të përshtatshme, Komisioneri kërkon të arrijë marrëveshje pajtimi mes ankuesit dhe personit kundër së cilit është paraqitur ankesa*”, Komisioneri vlerëson se është arritur efektiviteti dhe qëllimi për të cilin ishte iniciuar ankesa.

Në nenin 90/3 të ligjit nr. 44/2015 “*Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë*” parashikohet përfundimi i procedurës administrative: “*Procedura administrative, e nisur me kërkesë apo kryesisht, deklarohet e përfunduar pa një vendim përfundimtar për çështjen, në rastet e parashikuara në nenet 93-96 të këtij Kodi. Deklarata e përfundimit të procedurës administrative, pa një vendim përfundimtar për çështjen, përbën akt administrativ*”.

Njëkohësisht, në referencë të nenit 94/1, të ligjit nr. 44/2015 “*Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë*”, i cili parashikon se: “*Si rregull, në procedurën administrative të nisur me kërkesë, organi publik deklaron përfundimin e saj pa një vendim përfundimtar për çështjen, nëse pala që ka paraqitur kërkesën e tërheq atë*”, Komisioneri deklaron përfundimin e saj pa një vendim përfundimtar.

#### **PËR KËTO ARSYE:**

Mbështetur në nenin 90/3 dhe 94/1, të ligjit nr. 44/2015 “*Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë*”, nenin 1, nenin 7, pika 1, neni 20 dhe 21, pika 1, nenin 32, pika 1, shkronja a) e nenin 33, pikat 9-10, të ligjit nr. 10221, datë 04.02.2010 “*Për Mbrojtjen nga Diskriminimi*”, të ndryshuar,

Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

#### **V E N D O S I:**

1. Të deklarojë të përfunduar procedurën administrative për shqyrtimin e ankesës nr. 222 Regj., datë 01.11.2024, të të paraqitur nga z. R.M , pasi është arritur efektiviteti dhe qëllimi, për të cilin kishte filluar procedura hetimore.

2. Kundër këtij vendimi lejohet ankim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, brenda 45 ditëve nga marrja dijani.

**KOMISIONERI**

**Robert GAJDA**

Shkaku: Gjendja ekonomike  
Fusha: Arsim  
Lloji i vendimit: Arritje efektiviteti